



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref.nr. 01 / 2577 Dt. 01 / 11 / 2024

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Nr. 04/L-037, si dhe nenit 47, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, dhe Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik Ref.nr.01/1328 të dt. 26.06.2024, në mbledhjen XXI të mbajtur më datë 30.10.2024, vendos të shpall:

K O N K U R S

Për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit të rregullt akademik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan, për këto Fakultete:

I. FAKULTETI I EDUKIMIT

Emërim për herë të parë në thirrjen përkatëse:

Një (1) mësimdhënës për lëndë nga fusha e matematikës me plotësim norme në FSHK:

Lëndët: Konceptet themelore matematikore (Programi: Arsimi Parashkollor), Lojrat matematikore (programi: Parashkollor), Logjika Matematikore dhe Teoria e Bashkësive (programi Master: SKIA), Sistemet matëse dhe metrika (programi Master: SKIA), Statistika dhe Probabiliteti (programi Master: SKIA) dhe Metododat numerike (programi Master: SKIA).

II. FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Avancime ose riemërim:

Një (1) mësimdhënës/e, nga fusha e matematikës, për lëndët:

Matematika I për Informatikë (SHK), Matematika II për Informatikë (SHK), Probabiliteti dhe Statistikë (SHK), Teoria e Grafeve (SHK), Matematikë për mësimin e makinave (programi Master SKIA),



III. FAKULTETI EKONOMIK

Avancime ose riemërime:

Një (1) mësimdhënës/e, për lëndët:

Matematikë (Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar), Hyrje në matematikë (Marketing dhe Menaxhim i Shitjes), Matematikë financiare (Financë dhe Kontabiliteti aplikuar), me plotësim norme në Fakultetin e Edukimit.

Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesën;
- Biografinë (CV);
- Diplomat origjinale ose të noterizuara (me vulë origjinale të noterit) të studimeve themelore, masterit dhe doktoratës, (kandidatët e brendshëm të UKZ-së nuk kanë nevojë të sjellin këto dokumente, përveç nëse janë të reja dhe nuk janë sjellë më parë);
- Certifikatën e notave në tri nivelet e studimit (kandidatët e brendshëm të UKZ-së nuk kanë nevojë të sjellin këto dokumente, përveç nëse janë të reja dhe nuk janë sjellë më parë);
- Certifikatën e lindjes;
- Certifikatën e shtetësisë (ose certifikatën për vendbanimin në Republikën e Kosovës);
- Dëshmi (kopjet) për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.
- Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie dhe profesione tjera lidhur me fushën e mësimdhënies në arsimin e lartë;
- Certifikatë nga gjykata, se ndaj tij nuk janë duke u zhvilluar hetime;
- Dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore.



Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet baçelor apo master jashtë vendit duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i .

Kandidatët duhet të sjellin njërin prej këtyre dokumenteve si dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore:

- Të kenë të kryer njërin nivel të studimeve në gjuhën e huaj ose certifikatë IELTS, TOEFL, TOEIC apo ndonjë dokument tjetër të vlefshëm.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037, Statutin e Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, (shih:<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2020/12/STATUTI-I-UNIVERSITETIT-%E2%80%9DKADRI-ZEKA%E2%80%9D-N%C3%8B-GJILAN.pdf>) dhe Rregulloren Nr.01/1328 dt.26.06.2024 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në ueb-faqe të universitetit.

Dorëzimi i dokumenteve bëhet nga data **01.11.2024** deri më **15.11.2024** në orën **16.00**.

Kërkesa protokollohet në zyrën e arkivës AZ/04.

Aplikantët duhet të plotësojnë formularin F1 të cilin mund ta shkarkojnë nga ueb-faqja e universitetit, dhe në mënyrë elektronike së bashku me dokumentet e tjera e dërgojnë në info@uni-gjilan.net si dhe i tërë dokumentacioni sjellët në kopje fizike në UKZ.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit:

<http://www.uni-gjilan.net>

